

Niveli i studimeve Msc

Emertimi i programit: Mbrojtja e Bimëve

1. Objektivi kryesorë i kurrikules

Kurrikula e studimeve Master në Mbrojtja e Bimëve synon të rrisë kapacitetin, dukshmërinë, atraktivitetin dhe të përmirësojë pozicionimin e studentëve në tregun e punës, duke zhvilluar kurrikula tërheqëse që plotësojnë kërkesat e tregut. Gjithashtu, lejon diskutimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e bimëve, transferimin e informacionit dhe njohurive që nxisin zhvillimin ekonomik. Njohuritë e fituara përmes programit të studimit Mbrojtja e bimëve-Fitomedicinë mundësojnë aplikimin e njohurive dhe aftësive të fituara gjatë studimeve për zgjidhjen e suksesshme të problemeve komplekse në mjedise të reja ose të panjohura, veçanërisht në fushën shkencore të Mbrojtjes së bimëve. Ky program ka për qëllim që t'i aftësojë studentët që:

- a) njohuri të thella shkencore dhe teknologjike për të hartuar dhe menaxhuar risitë në mbrojtja e të bimëve dhe produktet bimore për të përmirësuar cilësinë, sasinë, higjienën dhe aspektet sanitare të produkteve bimore veçanërisht përmes aplikimit të MID;
- b) njohuri të thella për dëmtuesit e bimëve (dëmtuesit, patogjenët, barojat) dhe organizmat tjerë, ekologjinë, etiologjinë dhe epidemiologjinë e sëmundjeve, bio-etologjinë e dëmtuesve;
- c) njohuri të thella për sëmundjet jo parazitare dhe kontrollin e tyre;
- d) njohuri adekuate për të njohur sëmundjet e bimëve, dëmtuesit, barojat dhe organizmat e tjerë në kushtet praktike;
- e) njohuri të thella për ndikimin e përbërësve të agro-ekosistemit dhe praktikave kulturore në patogjenët bimorë, dëmtuesit, barojat dhe organizmat tjerë;
- f) njohuri të thelluara të mjeteve teknike, produkte për mbrojtjen e bimëve natyrore, sintetike dhe biologjike që përdoren për mbrojtjen e integruar dhe biologjike si dhe parandalimin e efekteve të mundshme negative të produkteve për mbrojtjen e bimëve.
- g) të zbatojnë kurrikulën përmes temave të planifikuara mirë dhe aktiviteteve mësimore të bazuara në rezultatet e pritura,
- h) të planifikojnë orët mësimore në përputhje me kërkesat e kurrikulës,
- i) të përdorin strategji të ndryshme të mësimit dhe të vlerësimit me studentin në qendër,
- j) të përgatisin materiale mësimore dhe të përdorin mediat digjitale në procesin mësimor,
- k) të zbatojnë njohuritë e thelluara shkencore në fushën e Mbrojtjes së bimëve në kontekstet e ndryshme shkencore.

2. Lëndët

Tabela 1. Përmbledhja e programit në procesin e akreditimit:

Viti I						
Semestri I			Orët/ Javët			
Nr.	O/Z	Lënda	L	U	ECT S	Ligjërues
1.	O	Planifikimet e eksperimenteve dhe analizat statistikore, Shkrimi shkencor, Prezantimi dhe Publikimet	2	2	6	Prof.Assis. Muhamet Zogaj Prof.dr. Muje Gjonbalaj
2.	O	Entomologjia e aplikuar për kulturat Bujqësore	2	2	6	Prof.ass.Dr.Fadil Musa Msc. Saranda Musa
3.	O	Ekologjia e barojave	2	2	6	Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti Msc. Rozafa Fetahaj
4.	O	Fitopatologji	2	2	6	Prof.ass.dr. Fadil Musa Dr.sc. Mufail Salihaj Msc. Saranda Musa
5.	O	Bazat e fitofarmacis (Kimia dhe Biokimia e Produkteve për Mbrojtjen e bimëve)	2	2	6	Prof.Assis. Muhamet Zogaj Prof.asic. Arben Mehmeti
Semestri II						
1	O	Akaralogji dhe Nematologji Bujqësore	2	2	6	Prof.ass.dr. Fadil Musa
2	O	Fitobakteriologji dhe Virusologji	2	2	6	Prof.ass.dr. Fadil Musa Msc. Saranda Musa
3	O	Menaxhimi i barojave	2	2	6	Prof.asoc. dr. Arben Mehmeti Msc. Rozafa Fetahaj
4	Z	Lëndët zgjedhore	2	2	6	Prof.Assis.Muhamet Zogaj Prof.dr.Xhevdet Elezi Prof.ass.dr. Fadil Musa Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti, Prof.aosc.dr. Mentor Thaqi
5	Z	Lëndët zgjedhore	2	2	6	Prof.Assis.Muhamet Zogaj Prof.dr.Xhevdet Elezi Prof.ass.dr. Fadil Musa Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti, Prof.aosc.dr. Mentor Thaqi
Semestri III						
1	O	Seleksionimi për rezistencë të dëmtuesve dhe stresi abiotik	2	2	6	Prof.dr. Sali Aliu
2	O	Kontrolli biologjike në Bujqësi dhe Biodiversiteti	2	2	6	Prof.ass.dr. Fadil Musa
3	O	Legjisllacioni në mbrojtjen e bimëve	2	2	6	Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti Msc. Rozafa Fetahaj
4	O	Praktikë	1	5	6	Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti Prof.ass.dr. Fadil Musa Prof.Assis.Muhamet Zogaj

5	Z	Lëndët zgjedhore	2	2	6	Prof.Assis.Muhamet Zogaj Prof.ass.dr. Fadil Musa Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti, Prof.aosc.dr. Mentor Thaqi
Semestri IV						
1	O	Punimi i Diplomës	50	30	O	

Lëndët zgjedhore

Semestri II dhe III			Orët/ Javët			
No.	O/Z	Lënda	L	U	ECT S	Ligjërues
1.	Z	Mjedisi dhe interaksioni i bimëve me produktet për mbrojtjen e bimëve	2	2	6	Prof.dr. Prof.Assis.Muhamet Zogaj
2.	Z	Aplikimi i pesticideve dhe pajisjet për mbrojtjen e bimëve	2	2	6	Prof.asoc.dr.Mentor Thaqi Prof.dr. Prof.Assis.Muhamet Zogaj
3.	Z	Entomologjia urbane	2	2	6	Prof.ass.dr. Fadil Musa
4.	Z	Diagnoza dhe bioteknologjia në patologjinë e bimëve	2	2	6	Prof.ass.dr. Fadil Musa
5.	Z	Fitocenologji bujqësore	2	2	6	Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti
6.	Z	GIS dhe resurset natyrore	2	2	6	Prof.dr. Xhevdet Elezi Prof.Assis.Muhamet Zogaj Prof.asoc.dr. Arben Mehmeti

Në dispozicion janë 6 lëndë zgjedhore, ku të gjithë studentët së bashku duhet të marrin shtesë 18 ECTS, 12 ECTS nga semestri II dhe 6 ECTS nga semestri i III = (90 ECTS + 30 ECTS punimi i temës së masterit = 120 ECTS).

Legjenda: O-obligative; Z- zgjedhore; L-Ligjërata; U- Ushtrime; Sistemi i Transferit të Krediteve ECTS në Evropë.

3.Kohëzgjatja e studimeve: 2 Vite (4 semestra) 120 ECTS

4. Mundësitë e punësimit dhe kualifikimit profesional

Pasi që nuk ka sistem informacioni mbi punësimin e studentëve pas diplomimit të tyre, ne nuk jemi në gjendje të japim shifrat e sakta për këtë çështje. Megjithatë, bazuar në burimet joformale që ne kemi gati 80% të studentëve të diplomuar në profilin e mbrojtjes së bimëve kanë gjetur punë dhe praktikojnë profesionin e tyre. Studentët e diplomuar janë të punësuar në sektorin privat dhe atë publik si ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorit Komunale, Doganat, Shkollat e mesme profesionale, institucionet financiare, organizatat joqeveritare lokale dhe ndërkombëtare, etj. Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e studentëve të diplomuar në nivelin Master mbajnë lidhje relativisht të mirë me Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV).